

VENDIM
Nr. 176, datë 26.3.2014

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E SHËNDETËSISË, TË SIPËRFAQES 12 600 M², PJESË E PRONËS NR. 84, ME EMËRTIMIN “ISH-REGJIMENTI I KIMISË”, ME VENDNDODHJE NË SHTISH - TUFINË, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Shëndetësisë, të sipërfaqes prej 12 600 (dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind) m², pjesë e pronës nr. 84, me emërtimin “Ish-Regjimenti i Kimisë”, me vendndodhje në Shtish - Tufinë, Tiranë, sipas planvendosjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për ndërtimin e një spitali të psikiatrisë ligjore dhe të një qendre kurative për të sëmurët me probleme të kolonës vertebrale.

2. Sipërfaqja prej 12 600 (dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind) m², pjesë e pronës nr. 84, me emërtimin “Ish-Regjimenti i Kimisë”, me vendndodhje në Shtish - Tufinë, Tiranë, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Ministrisë së Shëndetësisë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Shëndetësisë dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLAN RILEVIMI

Prona Nr.84. Siperfaqja dhe objektet që kërkohen për kalim kapital nga
Ministria e Mbrojtjes, Ministrisë së Shëndetësisë.



MIRATOHET
Komandant i Forcës Toksore
Gjenerali Major Zyber DUSHKU

IDENTIFIKIMI I PASURISE

Zona Kadastrale 3426
Nr.Pasurise Vol. Fq
Indeksi i Hartes
K-34-88-(236-A), K-34-88-(236-B).
Shkalla 1: 2500
Adresa e pasurise Tirane
Q/F Shish Tufine, Komuna Dajt.
Pronari :
Ministria e Mbrojtjes, Forcat Toksore

PERGATITI
Ing.Albert MURATI

DREJTORI I IGJU-së
N/Kol. Armir ÇANI

Punuar dt.17 janar 2014

Shpjeguese:

Sip.Përgjithshme e pronës nr.84 = 40321.4 m²

Sip.dhe objektet që kërkohet për kalim M.SH = 12600 m²

Kufiri i Repartit

Shenim: Ky plan-rilevim u përgatit sipas planvendosjes së kësaj prone
marre nga arkivi i I.GJ.U-së dhe matjeve të bëra në terren më
dt.17.01.2014 në prani të përfaqësuarit të F.T z.Vasil LELAJ dhe në
zbatim të shkresës së Drejtorisë së përgjithshme të
shërbimeve mbështetëse në MM me Nr.251/1 dt.14-01-2014.



